



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:294589

Datë: 10.07.2023

Numri i dokumentit: 04469035

APS.nr.15/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – DEPARTAMENTI SPECIAL, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi – kryetar i kolegjit, Bashkim Hyseni dhe Vatton Durguti – anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, në çështjen penale ndaj të akuzuarve Xh.SH., S.SH. dhe I.S., për shkak të veprës penale pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par. 1 të KPRK-së, lidhur me veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 të KPRK-së, lidhur me nenin 281 par. 1 pika 1.9 të KPRK-së, XH.S. dhe I.S. edhe për veprën penale secili veç e veç, legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, si dhe i akuzuari A.G. për veprat penale ndihma në kryerjen e veprës penale legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par. 2 lidhur me par. lidhur me nenin 33 të KPRK-së dhe për veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës si dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarve, Xh.SH., av.Asdren Mekaj, S.SH., av.Naim Rudari, I.S., av.Halim Kuliqi, A.G., av.Besnik Berisha, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti Special, PS.nr.67/2019 i datës 27.09.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më 13.04.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, si dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarve Xh.SH., av.Asdren Mekaj, S.SH., av.Naim Rudari, I.S., av.Halim Kuliqi, A.G., av.Besnik Berisha, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special PS.nr.67/19 i datës 27.09.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

1. Historiku i çështjes

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special me aktgjykimin PS.nr.67/2019 të datës 27.09.2022, të akuzuarve XH.S., S.SH. dhe I.S., për shkak të veprës penale pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par. 1 të KPRK-së lidhur me veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 të KPRK-së, lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.9 të KPRK-së, XH.S. dhe I.S. edhe për veprën penale secili veç e veç, legalizimi i përmbytjes së rreme nga neni 403 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, si dhe i akuzuari A.G. për veprën penale ndihma në kryerjen e veprës penale, legalizimi i përmbytjes së rreme nga neni 403 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, i ka shpallur fajtor dhe i ka gjykuar si në vijmë: Të akuzuarin XH.S. për veprën penale si nën pikën e I të dispozitivit të aktgjykimi i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej tetë (8) vite e gjashtë (6) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumë prej njëzet e pesë mijë € (25,000.00 €),

Ndërsa për veprën penale si nën pikën e II- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti.

Komfor nenit 76 par.2 nënpar.2.2 të KPRK-së, të akuzuarit XH.S. për veprat penale si nën I. dhe II. të dispozitivit i shqipton dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej nëntë (9) vite, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 02.12.2018 e tutje si dhe dënimin me gjobë në shumë prej njëzet e pesë mijë euro (25,000.00 €), të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, apo me pëlqimin e tij mund ta paguaj edhe me këste.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata, dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, duke iu llogaritur njëzet euro (20 €), për një ditë burgimi.

Të akuzuarit S.SH., për veprën penale si nën pikën e I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej shtatë (7) vite, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 02.12.2018 e tutje, si dhe dënimin me gjobë në shumë prej pesëmbëdhjetë mijë euro (15,000.00 €), të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, apo me pëlqimin e tij mund ta paguaj edhe me këste;

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata, dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, duke iu llogaritur njëzet euro (20 €), për një ditë burgimi;

Të akuzuarit I.S., për veprën penale si nën pikën e I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej tetë (8) vite e gjashtë (6) muaj, i dhe dënimin me gjobë në shumë prej njëzet e pesë mijë euro (25,000.00 €).

Ndërsa për veprën penale si nën pikën e II- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti;

Komfor nenit 76 par.2 nënpar.2.2 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton dënimin unik me burgim dhe dënim me gjobë: Për veprat penale si nën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej nëntë (9) vite në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 02.12.2018 e tutje, si dhe dënimin me gjobë në shumë prej njëzet e pesë mijë euro (25,000.00 €), të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, apo me pëlqimin e tij mund ta paguaj edhe me këste;

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata, dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, duke iu llogaritur njëzet euro (20 €), për një ditë burgimi;

Të akuzuarit A.G., për veprën penale si nën pikën e III-të, të dispozitivit të aktgjykimi, i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 26.03.2019 deri me datën 05.07.2019.

Konform neneve 62 e 69 dhe nenit 273 par.5 të KPRK-së dhe 276, 278 e 282 të KPPRK-së, të akuzuarve iu ka shqiptuar dënim plotësues; marrja e sendit -konfiskimi, sendet e përdorura apo të destinuara për kryerjen e veprës penale dhe sendet të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale dhe atë: Sasia e narkotikut e llojit “Heroinë”, në peshë bruto prej 113 kg e 507 gr, e sekuestruar në banesën e marrë me qira nga i ndjeri N.C. në Prishtinë, në lagjen Mati rruga “.....”, obj.C-2LL-C, nr.36 dhe disa gram Heroinë të konfiskuara në banesën e marrë me qira nga të akuzuarit XH.S. dhe N.C., në Fushë Kosovë, afër spitalit “Euromed”, substancë e kundërligjshme e përdorur në kryerjen e veprës penale, e që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit;

Kurse ndaj të akuzuarve sikurse më poshtë janë konfiskuar sendet:

- Vetura BMW 7L 710 Ld x Drive, prodhim i vitit 2015 me numër WBA7G61050G509422, me targa 01-700-JI, së bashku me çelësa të cilën veturë e posedonte tani i ndjeri N.C.; Pllakat e mermerit të sekuestruara në Ferizaj, në depon e biznesit S.SH. B.I; Nga tani i ndjeri N.C., konfiskohen: pasaporta me të dhënat L.N. dt.11.07.1971, me nr. P01039788 dhe dokumentet tjera si: letërnjoftimi, patent shoferi dhe ekstrakti i lindjes, pasaporta me të dhënat Lj.Sh. dt.08.01.1979 me nr. P01299970 dhe letërnjoftimi, një telefon i llojit Samsung me ngjyrë të zezë me kartelë, një telefon i llojit Iphone 7 (i dëmtuar/thyer), me ngjyrë të zezë dhe dy telefona të llojit “Black berry”, me ngjyrë të zezë me nga një kartelë;

Nga i akuzuari I.S. konfiskohen: Pasaporta me të dhënat M.Gj., dt. 29.12.1982, në Bukosh me nr. P01303398 dhe ekstrakti i lindjes, para 4x100€, 3x20€, 2x5€, 2x200 Lira turke, 3x10 lira turke, një telefon i llojit Iphone X me ngjyrë të zezë, me numër serik 353053095176396, një telefon i llojit Nokia me ngjyrë të zezë; Nga i akuzuari XH.S., konfiskohen: Pasaporta me të dhënat S.Sh., i lindur me 18.02.1950, në fshatin, me nr. P01322201, letërnjoftimi dhe ekstrakti i lindjes, para 2x500€ 4x50€, 4x10€, 1x5€ monedha metalike në vlerë prej 3 € dhe një telefon e llojit Nokia; Nga i akuzuari S.SH., konfiskohen: një telefon i llojit Iphone 7, ngjyrë e zezë, para 1x500€, 1x200€ dhe 1x50€; Nga M.K., konfiskohen: një unazë ngjyrë ari, dy vath ngjyrë ari, dy zingjir dore, një zingjir dore me dy rruza të kuqe, sende këto (dhurata), të cilat ia ka dhuruara tani i ndjeri N..

Me aktvendim të veçantë PS.67/19, të datës 27 shtator 2022 gjykata komfor nenit 367 par.1 pika 1.1 lidhur me par. 2; 6 dhe 7 të KPPRK-së, të akuzuarve XH.S., S.SH. dhe I.S., i'u është vazhduar masën e paraburgimit deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit por jo më shumë se dënimi i shqiptuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, Urdhërohet shkatërrimi i lëndës narkotike e llojit "Heroinë" në peshë bruto prej 113 kg e 507 gr, e sekuestruar në banesën e marrë me qira nga i ndjeri N.C. në Prishtinë, në lagjen Mati rruga ".....", objekti C-2LL-C, nr.36 dhe disa gram "Heroinë" të konfiskuara në banesën e marrë me qira nga të akuzuarit XH.S. dhe N.C. në Fushë Kosovë afër spitalit "Euromed", substancë e kundërligjshme e përdorur në kryerjen e veprës penale;

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, Obligohet Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar, të merr nën administrimin e saj pasurinë e konfiskuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi (Veturën BMW dhe pllakat e mermerit) dhe të njëjtën ta shes apo administroj në përputhje me Ligjin për Agjencinë Administrimin e Aseteve të Konfiskuara.

Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguajnë shpenzimet aq sa do të llogariten sipas shpenzimeve të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajë secili veç e veç shumën prej dyqind euro (200 €), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohen të akuzuarit që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë secili veç e veç shumën prej pesëdhjetë euro (50 €), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në pikën IV i akuzuari A.G. në bazë të nenit 364, par. 1 nënpar. 1.3 të KPP-së është liruar nga akuza, sepse me datë 24.12.2018, me dashje ka përpiluar dokument të falsifikuar, autorizimin nr. Lrp.nr. Rendor 229/2018 dhe numër të referencës 311/2018 të lëshuar kinse në emër të Noteres F.P. në Pejë, me qëllim shfrytëzimi të këtij dokumenti si origjinal me të cilin autorizim paraqet faktin se kinse autosalloni "E...", me përfaqësues V.B. e autorizon të ndjerin (N.C.) me të dhënat Lj.Sh. i lindur me 28.01.1979 shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal 1248837876 ku formalizon blerjen e sendit të luajtshëm BMW 7L 710 Ld x Drive, prodhim i vitit 11.11.2015 me numër WBA7G61050G509422 dhe targa 01-700-JI, në vlerë rreth 80, 000.00 €, të cilin autorizim ja jep të ndjerit N. i cili e shfrytëzon si të vërtetë, i cili autorizim me datë 02.12.2018

është gjetur dhe sekuestruar nga banesa e të ndjerit, sepse nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

Prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikë së Kosovës, për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykim e ankimuar ta ndryshoj ashtu që të akuzuarve XH.S., S.SH. dhe I.S. të i'u shqiptoj dënim me të lartë dhe A.G. të shpallë fajtor dhe të dënohet në bazë të ligjit edhe për veprën penale falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par 2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit XH.S., av.Asdren Mekaj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale (neni 384 par.1 pika 1.8 lidhur me nenin 337 par.2 dhe 338 par.1 dhe nenin 132 par.6 pika 1.12 lidhur me nenin 370 par.7 të KPP-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal 385 par.1 pika 1.1 dhe 1.3 të KPP-së dhe vendimit mbi dënim, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës, t'ia aprovoi ankesën si të bazuar dhe aktgjykim e ankimuar ta anuloj ashtu që çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje në atë mënyrë që të akuzuarin ta liroi nga akuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.SH., av.Naim Rudari, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale (neni 384 të KPP-së, shkeljes së ligjit penal 385 të KPP-së dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike neni 386 të KPPRK-së, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoi ankesën në tërësi si të bazuar ngase nuk është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale të cilën i vihet në barrë, të anuloj aktgjykimin e ankimuar i cili aktgjykim është plotësisht i pa drejtë i kundërligjshëm, arbitrar dhe jo i bazuar në fakte konkrete, me të cilin gjykata, padrejtësisht S.Sh. e ka shpallur fajtor lidhur me kryerjen e veprave penale pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par. 1 të KPRK-së, lidhur me veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 të KPRK-së, lidhur me nenin 281 par. 1 pika 1.9 të KPRK-së dhe tani të akuzuarin ta liroi nga akuza e cila nuk përmban dyshimin e

bazuar mirë dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë për të nxjerrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Mbrojtësi i të akuzuarit I.S., av.Halim Kuliqi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes se ligj penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës, t'ia aprovoi ankesën si të bazuar dhe aktgjykim e ankimuar ta anuloj dhe lëndën lënda t'i kthehet shkallës parë në rigjykim dhe rivendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.G., av.Besnik Berisha, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale (neni 383 par.1 nënpar.1.1 i KPP lidhur me nenin 384 të KPP-së shkeljes së ligjit penal nga neni 383.1 nënpar.1.2 të KPP-së lidhur me nenin 385 të KPP-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike neni 383 nënpar.1.3 i KPP-së lidhur me nenin 386 të KPP-së dhe vendim lidhur me sanksionin penal nga neni 383.1 nënpar.1.4 të KPP-së lidhur me nenin 378 të KPP-së, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës, t'ia aprovoi ankesën si të bazuar, të konstatoj se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes se ligjit penal në dëm të z.A.G. si dhe shqiptimi, të kundërligjshëm të sanksionit penal, apo ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe ta liroi nga akuza të akuzuarin A.G. apo të anuloj aktgjykim e ankimuar dhe ta kthen në rigjykim çështjen penale kundër të akuzuarit.

Përgjigje në ankesën e prokurorisë kanë paraqitur ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit A.G., av.Besnik Berisha, me propozim që ankesa e PS të refuzohet si e bazuar.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën, PPA/I.nr.171/23, datë 22.03.2023 ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikë së Kosovës, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet sa i përket pjesës liruese lidhur me pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi për të akuzuarin A.G. dhe i njëjti të shpallët fajtor edhe për veprën penale falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, për të cilat akuzohet dhe të dënohet sipas ligjit, ndërsa të akuzuarve XH.S., S.SH. dhe I.S. për veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor t'iu shqiptohet dënim me burg efektiv në kohëzgjatje me të lartë dhe dënim me gjobë në shumë më të lartë se sa në aktgjykimin e ankimuar, kurse ankesat e mbrojtëseve të akuzuarve Xh.SH., av.Asdren Mekaj, S.SH., av.Naim Rudari, I.S., av.Halim Kuliqi, A.G., av.Besnik Berisha, si dhe

përgjigjen në ankesën e PSRK-së, të parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit A.G., av.Besnik Berisha të refuzohen si të pa pabazuara.

Gjykata e Apelit e caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPP-së, në të cilën kanë marrë pjesë, të akuzuarit XH.S., S.SH., I.S. dhe A.G., si dhe mbrojtësit e tyre av.Asdren Mekaj, av.Naim Rudari, av.Halim Kuliqi dhe av.Besnik Berisha, ndërsa nuk ishte i pranishëm Prokurori i Prokurorisë së Apelit, edhe pse është njoftuar në mënyrë të rregullt nuk mori pjesë në seancë. Mbrojtësit e të akuzuarve pasi shpjeguan ankesat e tyre, theksuan se mbeten në tërësi pranë pretendimeve ankimore të paraqitura me shkrim, ndërsa të akuzuarit i mbështetën mbrojtësit e tyre.

2. Gjykata e Apelit e studioi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të dispozitës së nenit 394 par. 1 të KPPRK-së, vlerësoi pretendimet ankimore së bashku me shkresat tjera të lëndës, dhe konstatoi se:

Ankesat nuk janë të bazuara

Prokurori i Prokurorisë Speciale në ankesë lidhur me vërtetimit e gabueshëm të gjendjes faktike thekson se Gjykata ka vepruar drejtë kur të akuzuarit e lartë përmendur i ka shpallur fajtor për veprat penale për të cilat akuzohen, por lidhur me dënimin e ulët nuk i ka vlerësuar drejt rrethanat rënduese se veprat i kanë kryer me dashje direkte, nuk ka marrë për bazë shkallën e përgjegjësisë penale të tyre, kontributin esencial në kryerje të veprave penale andaj duke i pasur parasysh dënimet që parashihen për këto vepra penale, dënimi është i ulët, ndërsa me rastin e lirimit nga akuza për veprën penale në dispozitivin IV për A.G.n gjykata gabimisht ka konstatuar gjendjen faktike.

Sipas prokurorisë gjatë shqyrtimit gjyqësor, është provuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit me dashje direkte i kanë kryer veprat penale për të cilat ngarkohen, bazuar në këtë gjykata të njëjtit i ka shpallur fajtor dhe duke i dënuar me dënime pothuajse minimale, duke mos vlerësuar të kaluarën e të akuzuarve dhe natyrën e veprës penale. Duke u bazuar në të lartcekurat kërkon që të ashpësohet dënimi në maksimumin e lejuar ligjor për të gjithë të akuzuarit, i cili dënim do të ndikonte edhe në kryerësit tjerë potencial që të njëjtit të mos të kryejnë këtë lloje vepra penale.

Ndërsa sa i përket të akuzuarit A.G., për veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 për 2 lidhur me par. 1 KPRK-së, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit, në mënyrë të qartë përshkruan se si i akuzuari A.G., ia ka sjell autorizimin e veturës BMW të akuzuarit XH.S., për të ndjerin N.C., dhe se gjykata arriti në përfundim të gabuar.

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit XH.S., av.Asdren Mekaj, thekson se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje që kanë të bëjnë me kundërthënie në mes të përmbajtjes së dispozitivit dhe arsyetimit të tij, pastaj arsyetimi i aktgjykimit nuk përmban arsye të qarta e të plota për faktet qenësore, që gjykata i konsideron të vërtetuara. Aktakuza rëndon të akuzuarit se kanë kryer veprën penale pjesëmarrje ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par 1 të KPRK-së lidhur me veprën penale, blerje, posedim, shpërndarje e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par 2 të KPRK-së lidhur me nenin 281 par 1 pika 1.9 të KPRK-së dhe veprën penale legalizimi i përmbajtës së rreme nga neni 403 par 2 lidhur me par 1 të KPRK-së për të cilën i akuzuari e ka pranuar fajësinë.

Sipas mbrojtjes PSRK, dyshimin e bazuar mirë, për gjithë të akuzuarit e ka mbështet kryesisht në transkriptin e komunikimeve mes të akuzuarve, përfshirë dhe bisedat me tani të ndjerin N., në banesën e të cilit u gjet substanca narkotike, nga të cilat komunikime, përveç listimit të tyre, në arsyetim të aktakuzës, nuk bëri interpretim se çka në të vërtetë vërtetohet, cila ishte lidhja e tyre për ditën kritike kur substanca narkotike u gjet në banesë të tani të ndjerit.

Sipas mbrojtjes është shkelë dispozita e nenit 384 par 2 pika 2.1. të KPP-së, pasi aktgjykimi i Gjykatës së Tiranës është administruar si provë kinse për të rënduar situatën e të akuzuarve, mirëpo sipas mbrojtjes pikërisht nga ai aktgjykim, vërtetohet se i akuzuari XH.S., ishte dënuar në mungesë, së bashku me disa të pandehur, për të njëjtën vepër penale të krimit të organizuar dhe për të njëjtën vepër bazë, me të njëjtat fakte, e që kjo nuk është marrë parasysh fare nga gjykata.

Ka shtuar se gjykata e ka bazuar aktgjykimin e saj edhe në raporte policore të hartuara nga policët të cilat janë prova të papranueshme, sepse ato kanë rëndësi vetëm për mbledhjen e informacioneve gjatë një faze të hetimit, por nuk mund të përdorën edhe si provë në shqyrtimin gjyqësor, për këto arsye konsideron se aktgjykimi i shkallës së parë është i bazuar në prova të papranueshme dhe kjo paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 1.8 lidhur me nenin 259 par. 1 dhe 337 par.2 dhe 338 par.1 të KPP-së.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes së faktike konsideron se gjendja faktike në këtë çështje penale është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë, pasi gjykata për vërtetimin e faktit qenësor në këtë çështje penale, nëse i akuzuari XH.S. kishte ndërmarr veprimet, të cilat e rënduan dhe për të cilat u shpallë fajtor, gjykata pa mëdyshje është dashur të vërtetojë çdo veprim të tij me fakte dhe prova, e jo të shtrembëroj provat në dëm të tij, pasi pretendimet nga akuza se akuzuari XH.S. dy muaj më parë, paska hapur paketimet dhe nga bunkerët e pllakave të mermerit, paska nxjerr substancën narkotike dhe të nesërmen e paska vendosur në bagazh të veturës dhe të njëjtën e paska dërguar tek tani i ndjeri, nuk është vërtetuar si u bë kjo ndërlidhje, kur substanca narkotike nuk u gjend në veturë të ndonjërit të akuzuar, edhe pse të njëjtit ishin nën vëzhgim të masave të fshehta.

Ka shtuar se asnjë dëshmitarë nuk dëshmojë se atë ditë në ndonjë veturë u ngarkua narkotiku në fjalë, për me tepër dëshmitarët I.C., B.B., M.M., F.P., nuk vërtetuan në raport me të akuzuarin XH.S., ndonjë fakt lidhur me pretendimin e PSRK-së, dhe lidhur me këtë i është referuar deklaramit të dëshmitarit A.Z. i cili dëshmitarë përpos rrethanës se ishin shkarkuar nga kontejnerët pllakat e mermerit, nuk vërtetoj asnjë pretendim të PSRK ne raport me të akuzuarin XH.S., e as të akuzuarit tjerë.

Duke theksuar se nga kontaktet e dëshmitarëve M.K. dhe E.B. vërtetohet se këto të dyja, ishin në dijeni se në një dhomë tjetër të banesës kishte substancë narkotike dhe për t'i ik përgjegjësisë, koordinojnë mes veti dëshmitë e tyre, duke hedhur fajin tek të akuzuarit tjerë pra ato bënë skenarin e dhënies se deklaratave dhe për çudi u administruan nga PSRK-së.

Mirëpo kjo dëshmitare dëshminë e saj e ka dhënë në kundërshtim me komunikimet e bëra me dëshmitaren E.B. dhe sipas dëshmisë së saj e gjithë barra i vihet të akuzuarit S.SH. edhe përkundur faktit se ato kishin komunikuar dhe kishin qenë në dijeni për substancën narkotike të gjetur në dhomën tjetër. Prandaj në raport me të akuzuarin XH.S. nga kjo dëshmitare nuk u vërtetua asnjë pretendim akuzues, ashtu siç ka deklaruar edhe dëshmitarja E.B., pra se ditën kritike i akuzuari Xh.SH. nuk kishte qenë i pranishëm dhe që të dyja në të gjitha fazat e procedurës, përfshirë dhe shqyrtim gjyqësor, kanë thënë se të akuzuarin XH.S., nuk e njohin. Po ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor, është dëgjuar pronari i banesës në fjalë, dhe nga dëshmia e këtij dëshmitari, përpos rrethanës se ishte pronar i banesës në fjalë dhe të njëjtën ia kishte dhënë me qira një personi me kombësi turke, për të akuzuarin XH.S., nuk vërtetoj ndonjë veprim inkriminues.

Pastaj A.S., i dëgjuar në cilësi të dëshmitarit, si zyrtar policor i cili kishte qenë i autorizuar në zbatim të masave të fshehta, ka vërtetuar faktin se ditën kritike ishte gjetur narkotiku në banesën e tani të ndjerit, dhe në suaza të veprimeve hetimore, me kolegët, kishte shkuar në depo në Ferizaj, ku pas kontrollit të plakave të mermerit, kishte ardhur në përfundim se substanca narkotike kishte qenë e vendosur në bunkerët e hapur në pakot e pllakave të mermerit, duke e ndërlidh se narkotiku në banesë të tani të ndjerit, rrjedhtë nga ajo depo, pasi sipas tyre, ajo substancë narkotike ishte nxjerr nga bunkeri në fjalë. Dhe kjo për prokurorin mund e këtë qenë si indikacion, mirëpo, jo për gjykatën, pasi faktet duhet provuar me prova jo me supozime apo indicie, pasi që ky dëshmitarë nuk argumentoj me prova veprimet e ndërmarra ditën kritike.

Sa i përket provave materiale, shumica nga to nuk u kontestuan as nga i akuzuari, deri lidhur me transkriptim të bisedave telefonike, nuk provuan lidhjen e bartjes së substancës narkotike nga depoja e Ferizajt në banesën e tani të ndjerit, konsideron se me asnjë të vetmen provë nuk vërtetohet se kinse dy muaj më parë, paska ngarkuar narkotikun në veturë të tij dhe të njëjtën e paska dërguar në banesën e tani të ndjerit dhe për dy muaj radhazi narkotiku paska qëndruar në atë banesë, po ashtu është absurditet të mendohet lidhja e tani të ndjerit me këtu të akuzuarit, e në veçanti me të akuzuarin XH.S., vetëm mbi bazën e disa komunikimeve të bëra mes tij dhe tani të ndjerit, e aq me tepër kur tani i ndjeri asnjëherë nuk e pati mundësinë të dëgjohej lidhur me këto rrethana. Se tani i ndjeri, substancën narkotike e kishte sjellë pa dijeninë e të akuzuarve, tregon edhe komunikimi në mes të dëshmitarëve M.K. dhe E.B., të cilat siç u tha dhe më lart, me deklaratatë të tyre i dhënë kahje ndryshe rastit në fjalë.

Tutje, mbrojtja duke analizuar veprën penale të krimit të organizuar dhe lidhur me këtë vepër penale ka përshkruar dipozitivin sipas pikës I, e cila sipas nenit 283 KPPK, sipas aktakuzës, vepra penale është përshkruar si në paragrafët 1, 2, 3, 4,5 të kësaj dispozite ligjore, dhe në referim të dispozitave ligjore mbrojtja konsideron se në lidhje me të akuzuarin XH.S., mungojnë faktet se ata ishin duke vepruar si anëtarë të një grupi e aq më pak mund të konsiderohet se ata ishin duke vepruar si anëtarë të një grupi të organizuar kriminal.

Ky grup nuk mund të konsiderohet si i strukturuar. Nuk është kontestuese se të akuzuarit njihen mes veti, pasi tre nga ata janë familjarë të ngushtë dhe se organizatori doli të jetë tani i ndjeri, në të vërtetë pavarësisht se ata u njohën me njëri-tjetrin, faktet e vërtetuara nuk provuan asnjë element qenësorë të kësaj vepre penale. Nuk është e mjaftueshme të përshkruhet norma ligjore

e veprës penale të krimit të organizuar, gjykata ka pas obligim të vërtetojë çdo veprim të secilit nga të akuzuarit, se ata a kishin role të veçanta, të vërtetoj kur u formua ky grup, sa kohë ishte qëndrueshmëria, cilat ishin rolet e anëtarëve të grupit cilat ishin udhëzimet nga kryesuesi i grupit.

Sa i përket elementeve të veprës penale nga neni 273 par. 2 lidhur me nenin 281 par 1 pika 1.9, e cila dispozitë ligjore qartë përcakton se për tu kryer vepra penale në fjalë, ligjvënësi ka paraparë katër forma të kryerjes së kësaj vepre penale, pra shpërndarjen, shitjen, transportimin, apo dërgimin me qëllim shpërndarje, shitje ose ofertë për shitje, secili nga këto veprime paraqet formë të posaçme me të cilën kryhet kjo vepër penale. Pra për ekzistimin e kësaj vepre penale duhet të vërtetohen të gjitha rrethanat e rastit konkret, rëndësi të veçantë mund të ketë sasia e drogës, e që në këtë rast nuk ishte kontestuese se droga ishte gjetur në banesën e tani të ndjerit, mirëpo me asnjë provë të vetme në raport me të akuzuarin XH.S., nuk u vërtetua një nga katër format e veprimit me të cilat kryhet kjo vepër penale, pra provat e administruara nuk argumentuan se ai ditën kritike kishte shpërndarë, shitë, transportuar apo dërguar me qëllim të shpërndarjes, drogën e gjetur tek tani i ndjeri. Ndërlidhja e vetme e pretenduar ishte vetëm një supozim i PSRK-së, se kinse këtu i akuzuari XH.S. me dt. 14.12.2018, kishte ngarkuar drogën në fjalë dhe të njëjtën e kishte dërguar në banesën e tani të ndjerit me veturën e tij, por në asnjë mënyrë nuk u vërtetua kjo.

Lidhur me shkeljen e ligjit penal, mbrojtja thekson se Gjykata e shkallës së parë në rastin e vendosjes së kësaj çështje gjykata shkeli parimin *ne bis in idem* kur të njëjtit për të njëjtat vepra dhe për të njëjta rrethana dhe fakte i shpalli fajtor, që tërheq dhe shkeljen e ligjit penal.

Lidhur me vendimin për dënimin gjithashtu ka theksuar me rastin e vendosje lidhur me matjen e dënimit, Gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat që ndikojnë në matjen e dënimit siç është përcaktuar me nenin 69 të KPRK-së dhe për pasojë të akuzuarit i ka shqiptuar një dënim që nuk është në proporcion as me shkallën e përgjegjësisë penale, por as me intensitetin e pasojës, e cila mungon në rastin konkret. Si rrethanë lehtësuese nuk morri parasysh pranimin e fajësisë për veprën penale nga pika II, moshën e tij të shtyrë, pendimin për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe mbi bazën e vlerësimit të këtyre rrethanave, t'i shqiptoj një dënim i cili do të korrespondoj me qëllimin e dënimit.

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit S.SH., av.Naim Rudari, ka theksuar se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 i KPRK-së,

konkretisht në shpërburje me paragrafët 1.8 ku aktgjykimi bazohet në prova të pa pranueshme, 1.12 aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 par.6 të KPPK-së po ashtu në shpërputhje me nenin 384 par.2 nënpar 2. 1 të KPPK-së.

Sipas mbrojtjes, aktgjykimi i ankimuar bazohet në provë të papranueshme, kryesisht bazohet në deklaratat e rreme të dy të dëshmitareve kryesore M.K. dhe E.B. të cilat shpëtuan veten e tyre duke deklaruar rrejshëm kinse S.SH. e ka ditur, që në banesën e të ndjerit N. C. kishte substanca narkotike e nga bisedat telefonike kuptohet qartë se M.K. dhe E.B. e kanë ditur se në banesën e të ndjerit N. C. kishte substanca narkotike madje të njëjtat tentuan që t'i largojnë ato, referuar bisedës telefonike të datës në ora 16:39:41 kur M.K. merr telefonin e S.Sh. i cili ishte nën masën e përgjimit ligjor dhe nga ai numër, e thirr E.B. e cila kishte ikur nga vendi i ngjarjes pasi që kishte vjedhur gjësende me vlerë nga banesa e të ndjerit N. C..

Ka shtuar se aktgjykimi është bazuar paragjyqime dhe se gjykata vetëm për ta përmbushur kushtin e tre personave për t'i futur grupin kriminal të organizuar është dashur detyrimisht që të shkruan edhe diçka për S.Sh., edhe pse për të njëjtin nuk është argumentuar me asnjë provë se ai ka ditur që në banesën e të ndjerit N. C. kishte narkotikë dhe se nuk vërtetohet se S.SH. së paku një herë t'i ketë shitur dikujt substanca narkotike apo të këtë ndihmuar ndokënd për të shitur substanca narkotike e aq më pak ë këtë qenë pjesë e ndonjë grupi kriminal të organizuar.

Me tutje mbrojtja ka shpjeguar mënyrën se si me insistimin e prokurorisë kanë lidhur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë (edhe pse nuk kishte prova për të akuzuarin S.SH.) me premtim se do të largoi veprën penale pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal organizuar nga neni 283 paragrafi I KPRK-së dhe do të nënshkruajmë marrëveshje në këmbim të pranimit të fajësisë të akuzuarit të dënoshin për aq sa kishin qëndruar nën masën e paraburgimit, që kishte rreth dy vite nën masën e paraburgimit. Lidhur me këtë ka shtuar se edhe pse nuk dihej se çfarë kishte prokuroria lidhur me S.Sh. ngase nuk dija se çfarë t'i thoja S.. të pranonte për të hyrë në marrëveshje mbi pranimin e fajësisë dhe po ashtu edhe S.. kishte qëndrimin e njëjtë dhe nuk dëshironte të hynte në asnjë marrëveshje për pranimin e fajësisë, por prokuroria insistonte se të pandehurit ose duhet të futen që të gjithë në marrëveshje ose asnjëri sepse prokuroria nuk do të lidhë marrëveshje të pjesshme.

Në shqyrtimin gjyqësor për kundër kundërshtimeve të mbrojtjes është dëgjuar dëshmitari A.S.. I cili kishte qenë hetues dhe mbikëqyrës i atij operacioni si dhe mbikëqyrës i marrjes në pyetje të akuzuarve madje edhe gjatë dëgjimit të akuzuarve në prokurori dhe kishte qenë në rolin aktiv

parashtrimin të pyetjeve, kurse nga gjykata është ftuar në cilësi të dëshmitarit për të mbuluar mangësitë që kishte prokuroria apo më mirë të thuhet aty ku nuk mund të argumentonte prokuroria me prova konkrete mjaftonte për gjykatën që të thoshte ky dëshmitarë unë mendoj dhe se mendimi dhe paragjykimi i tij të merret si provë. Ai nuk kishte njohuri për veprimet apo mosveprimet e S.Sh. ndonëse vetëm ndonjëherë kalimthi e përmend S.Sh. dhe atë duke e thënë se ai është përfshirë shumë rrallë, e kur e thoshte këtë, kishte fjalën që ai është përfshirë rrallë në takimet që ka mbuluar policia duke i vëzhguar dhe tutje i është referuar deklarimi të këtij dëshmitari rreth pyetjeve dhe përgjigjeve të dëshmitarit të ushtruar nga mbrojtja gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Për kundër kësaj gjykata në aktgjykimin e ankimuar në faqe 34:73 ka përshkruar se: u vërtetuar se i ndjeri N. C. ishte i dashuri i M.K. dhe me të ishte në lidhje dashurie për një periudhë të shkurtës kohore, gjatë asaj kohë edhe i kishte blerë dhurata të shtrenjta. Po ashtu gjykata edhe pse ka pasur në dispozicion videoincizimet e nxjerra nga kamerat e sigurisë ndërtesës ku banonte N. C. dhe shihet mjaft mire se aty kishin shkuar M.K. dhe E.B. dhe kishte edhe deklaratat që S.Sh., e kanë ftuar ato të dyja për të shkuar e të cilin e kishte porositur edhe I.S. –nipin e tij që të shkonte atje, por gjykata nuk e specifikon këtë kinse për të arsyetuar M.K. dhe E.B., duke e ngarkuar kështu S.Sh. kinse ai ka shkuar atje i pari dhe në përshkrim e rendit të parin.

Sipas mbrojtës aktgjykimi i ankimuar nuk përmban argumente të vërtetuara në shqyrtim gjyqësor, gjykata nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare në të cilat mbështetet aktgjykimi, përderisa shkresat e lëndës e thonë të kundërtën e asaj që është përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit, po ashtu aktgjykimit të ankimuar krahas me veprën penale për të cilën S.SH. është shpall fajtor nuk i janë bashkëngjitur faktet dhe rrethanat që përbejnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të KPP-së neni 370 par.4 e lidhur me nenin 36.5 par.1, nënpar. 1.1 të KPP-së.

Duke shtuar, se në aktgjykimin e ankimuar tre të akuzuarit, dy vëllezër dhe djalin e njërit të akuzuar, janë shpallë fajtor dhe se konsideron se nuk janë përmbushur elementet e domosdoshme për grup të organizuar kriminal, por kemi të bëjmë me një familje e assesi me ndonjë grup, nuk kanë qenë të dyshuar dhe as të dënuar më parë për vepra penale së paku i akuzuari S.SH., nuk ka qenë i dënuar më parë për asnjë vepër penale ndërsa përderisa nuk

Po ashtu mbrojtja i është referuar aktgjykimit të ankimuar faqe 38/73 duke elaboruar përshkrimin e aktgjykimit, me pretendim se gjykata nuk ka dhënë arsye se përse M.K. është dëshmitare në këtë çështje, kur e njëjta ka qenë e dashura e organizatorit të këtij grupi kriminal dhe se ditën kur është gjet droga në banesën e të dashurit, ajo në bisedën telefonike me E.B. biseduan si ta heqin sasinë e drogës por kishin frikë nga policia më pas nuk guxuan ta prekin, dhe ato u nxorën duke e ngarkuar S.Sh., dhe duke gënjyer se ato nuk kanë ditur por S.SH. u ka treguar aty ka drogë dhe me këtë ato u bënë dëshmitare.

Nga kjo rrjedh se gjykata i ka besuar gënjeshtërs së dëshmitares i cila ka dëshmuar se S.SH. ishte i shqetësuar tërë kohën, ka folur në telefon dhe nuk i ka lejuar që ta thërrasin ndihmën e shpejt dhe policinë....., po ashtu mbrojtja duke e përshkuar aktgjykim e ankimuar shton se i njëjti në faqen 39/73 nuk ka dhënë arsye se pse ia falin besim këtyre dëshmitarëve, për kundër faktit gjykata ka pasur prova të mjaftueshme materiale për të vërtetuar gjendjen faktike si CD me videdoicizime ku përshkruhet se E.B. ishte larguar me një qese në dorë e që behet fjalë për gjësendet e vjedhura dhe këtë gjykata e ka vërtetuar me mostra të ADN-së, se E.B. dhe M.K. kishin qenë në banesën ku ishte gjetur droga edhe një ditë me parë por gjykata përfundimisht aktgjykimin e bazon në gënjeshtër të tyre e jo në provat materiale.

Lidhur me shkeljen e ligjit penal mbrojtja thekson se gjykata e shkallës së parë në raport me të akuzuarin S.SH. ka bërë ka bërë shkeljen e ligjit penal për faktin i njëjti është në kundërshtim të plotë me nenin 385 par.1, nënpar.1.1 i KPP-së, sepse nuk është vërtetuar se kanë ekzistuar veprimet kundër ligjore të S.Sh. të cilat do të përbenin elementet e veprës penale bazë për shkak se nuk janë vërtetuar elementet objektive dhe subjektive të veprës penale, për të cilat i njëjti është shpallur fajtor.

Duke shtuar se nuk është bërë përshkrimi se cilin veprim inkriminues e ka ndërmarrë S.SH. në drejtim të veprës penale, kur S.SH. ka poseduar substanca narkotike, kur ka shitur apo shpërndarë përveç faktit se S.SH. është njohur me të ndjerin N. C. në banesën e të cilit janë gjetur substancat narkotike, S.SH. është njohur me të akuzuarin XH.S. dhe e ka vëlla të njëjtin, dhe se S.SH. është njohur me të akuzuarin I.S. të cilin e ka nip, respektivisht I. është djali i të akuzuarit XH.S. dhe se ditën kritike S.SH. ishte thirrur nga I.S. për të shkuar të banesa e të ndjerit për t'i ndihmuar M.K. dhe E.B., pasi që i ndjeri nuk ua kishte hapur telefonin M. dhe E., dhe se S. e kishte thirrur M.K.. Andaj në rastin konkret nuk ekzistojnë argumente për veprën penale "Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar" nga neni 283 të KPRK-së për të

cilën veprë S.SH. është akuzuar dhe është dënuar, po ashtu nuk ka është argumentuar për asnjë moment vepra penale "blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar c narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge" nga neni 273 të KPRK-së për të cilën S.SH. është akuzuar dhe dënuar, ashtu që në raport me këto vepra penale i është referuar dispozitave ligjore nga neni 273 dhe 283 të KPRK-së se çka përcaktojnë.

Gjykata gabimisht ka ardhur në përfundim se S.SH. ishte pjesë e një grupi të organizuar kriminal, dhe se gabimisht ka vërtetuar se S.SH. ka ditur se në banesë e tani të ndjerit N. C. kishte substanca narkotike, se e ka pasur çelësin e dhomës ku ka qenë e vendosur substanca narkotike, se në banesën e të ndjerit N. C. ka shkuar i pari S.SH. dhe se substanca narkotike i ka sjell S.SH. në banesën e të ndjerit.

Nga arsyet e lartcekura aktgjykimi i ankimuar, përveç shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal është i përfshirë edhe vërtetimin e gabuar dhe jo i plotë të gjendjes faktike të cilat shkelje aktgjykimin e tillë e bëjnë të paqëndrueshëm të padrejtë dhe të kundërligjshëm.¹

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit I.S., av.Halim Kuliqi, deklaron se aktakuza është ndërtuar mbi bazën e dëshmimeve të A.S.t, hetues i krimi të organizuar me narkotikë, ku i njëjti ka deklaruar se nga koha 18 nëntor 2017 grupi kriminal i strukturuar kanë qenë nën masat e vëzhgimit dhe përgjimit, megjithatë si është e mundur që një grup kriminal, prej disa vetash të jenë nën masat e vëzhgimit kriminalistik të organeve të hetuesisë e të mos zbulohet asgjë për ta, asnjë provë faktike, as foto, apo prova të tjera, bazuar në këtë krejt organi i hetimeve por edhe gjykata kanë vepruar me dyshime dhe kjo përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që aktgjykimi është bazuar në prova të pa papranueshme dhe për këtë duhet të anulohet.

Sipas mbrojtjes dëshmitë e dëshmitarëve I.H., I.C., S.M., M.M., F. M. dhe E.B., nuk është provuar asnjë fakt që këta lidhen me kryerjen e veprës penale nga i akuzuari, në deklaratimet e tyre nuk e përmendin, as nuk e njohin dhe as kanë njohuri për ndonjë veprim antiligjor të kryer nga ky i akuzuar. Ka shtuar se në aktgjykimin e ankimuar gjykata e shkallës së parë përmend faktin se kur me 19 tetor 2018 janë publikuar emrat e tyre si persona të dyshuar Xh.SH. dhe I.S. me qëllim të fshehjes se identitetit kanë paraqitur fakte të rreme në qendrën e regjistrimit civil në Prishtinë dhe Obiliq, kështu që të njëjtit, kanë ndërruar identitetet e tyre duke marr edhe

¹ Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit S.SH.- avokat Naim Rudari.

letërnjoftime dhe pasaportat e falsifikuara ku I.S. ka marr identitetin M.Gj. kurse XH.S. identitetin S.Sh., mirëpo këto fakte nuk i ka vërtetuar gjykata me asnjë provë apo fakt.

Tutje sipas mbrojtjes provat të cilat janë në shkresat e lëndës nuk provojnë në asnjë mënyrë, asnjë fakt se i akuzuari I.S., ta ketë kryer veprën penale nga neni 283 par.1 të KPRK-së lidhur me veprën penale nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 283 par.1 pika 1.9 të KPRK-së.

Prandaj për të akuzuarin, me asnjë provë të vetme nuk janë gjetura prova se i njëjti të jetë i përfshirë në ndonjë grup kriminal të organizuar e as në veprime me asnjërin prej pjesëtarëve të grupit kriminal të supozuar siç pretendon akuza përveç faktit se me të akuzuarin XH.S. janë baba e bir, kurse me të akuzuarin S. janë nip e axhë, prokuroria me asnjë provë nuk ka arrit ta argumentoj lidhjen në veprimet kriminale me ndonjë foto gjatë bisedës me ndonjërin nga anëtarët e grupit ose person që lidhet me drogën e gjetur tek i ndjeri N. C. kurse në anën tjetër akti akuzues, në tërësinë e tij kryesisht flet për persona të tjerë e vetë nën dyshimet rreth bisedave telefonike të cilat nuk rezultojnë të jetë i përfshirë këtu i akuzuari.

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit A.G., av.Besnik Berisha, thekson se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parapara nga neni 384, par. 1, nënpar. 1.8, 1.10 edhe 1.12, si dhe 384.2, nënpar. 2.1, lidhur me nenet 3.2, 7.2, 8.2, 9.1, 123-5, 262, 360.1, 361 të KPP-së, për shkak se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i paqartë dhe kontradiktor në brendinë e tij, gjykata e shkallës së parë ka dështuar që të japë arsye të qarta, të sakta, koherente, faktikisht të mbështetshme dhe juridikisht të qëndrueshme lidhur me faktet vendimtare të vërtetuara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe të përshkruara në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit.

Sipas mbrojtjes gjykata e shkallës së parë e ka mbështetur aktgjykimin në prova të papranueshme, në kundërshtim me ndalesën nga neni 123-5 i KPP-së, përkatësisht ka përcaktuar përgjegjësinë penale të akuzuarit A.G., mbështetur në deklaratat e dhëna në procedurë paraprake nga bashkë i akuzuari Xh.SH.. Gjykata e shkallës së parë me aktgjykim ka tejkalluar akuzën, sepse ka formuluar një përshkrim faktik të ndryshëm nga ai i aktakuzës, duke e gjykuar dhe privuar të akuzuarin A.G. nga e drejta për të paraqitur mbrojtjen e tij.

Lidhur me shkeljen e nenit 370.7 të KPP-së, mbrojtja thekson se gjykata e shkallës së parë, në tërësinë e arsyetimit të aktgjykimit të atakuar, ka dhënë arsye të mangëta, konfuze, të pasakta, faktikisht të pa mbështetshme dhe juridikisht të paqëndrueshme lidhur me faktet vendimtare të përshkruara në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar të cilat fakte nga pika në

fjalë kanë të bëjnë, kinse vjedhjen e identitetit të shtetaseve të Republikës së Kosovës, me të dhënat Lj.Sh. dhe me të dhënat MGj. dhe lidhur me këtë Gjykata e shkallës së parë mbështet vërtetimin e këtyre fakteve vendimtare bazuar në: Deklaratën e të bashkëpandehurve XH.S. dhe I.S., dhënë gjatë fazës së hetimeve dhe Transkriptet e bisedave telefonike të numrit 049 198 198, i cili nuk ka qenë kurrë në shfrytëzim të akuzuarit A..

Andaj vërtetimi i fakteve vendimtare bazuar në deklaratat e të bashkëpandehurve XH.S. dhe I.S. përfshin aktgjykimin e atakuar në Shkelje esenciale nga neni 384.2, nënpar. 2,1, lidhur me nenin 262, par. 1) dhe par. 2) të KPP-së, sepse Gjykata e shkallës së parë ka përcaktuar fajësinë e të akuzuarit A.G. bazuar mbi deklaratime të pandehurve, të dhëna në Polici dhe Prokurori, në raport me të cilat as i akuzuari A.G., dhe as mbrojtësi nuk kanë pasur mundësi që t'i kundërshtojnë përmes marrjes në pyetje të pandehurve gjatë fazës së hetimit.

Për shkeljet dispozitive ligjore, thekson se aktgjykimi i ankimuar përfshihen në shkelje me e nenit 361 par.2 të KPP-së, për faktin se Gjykata e shkallës së parë ka dështuar plotësisht që të vlerësojë me çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e siç imponohet nga neni në fjalë, për arsyet që i ka shtjelluar me lartë, kurse lidhur me nenin 360 par. 1 të KPP-së ka theksuar se me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë, ka tejkalluar akuzën, sepse ka gjykuar sipas një gjendje faktike të ndryshme, nga faktike e përshkruar në aktakuzë e cila nuk ka qenë subjekt i ndryshimeve nga prokuroria dhe tutje i referohet përshkrimit sipas aktakuzës për të akuzuarin A.G. dhe nga kjo rrjedh se gjendja faktike e përshkruar në aktakuzën PS dhe kualifikimi i saj ligjor lidhur ndryshon rrënjësisht me përshkrimin faktik nga pika III e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, jo vetëm sa i përket kualifikimit juridik, por veçanërisht sa i përket përshkrimit faktik për të cilin është akuzuar dhe përshkrimit faktik për A. është shpallur fajtor dhe është dënuar.

Përderisa përshkrimi faktik nga pika III e aktakuzës esencialisht i referohet ndihmës në shmangien, zbulimin dhe mos arrestimin e të pandehurve shtetasve turk Xh.SH., I.S. dhe të ndjerin N. C. nga organet e ndjekjes së Shqipërisë dhe Kosovës dhe bërjen e tyre të pakapshëm për organet e drejtësisë dhe me qëllim të përfitimit pasuror, në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, Gjykata e shkallës së parë gjykon të akuzuarin A.G. në drejtim të ndihmës së të akuzuarve në legalizimin e përmbajtjes së rreme. Nga kjo rezulton se Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, ka gjykuar të akuzuarin A.G. për përshkrimin tjetër faktik, të formuluar nga vetë Gjykata, thellësisht të ndryshëm nga përshkrimi faktik në aktakuzën e prokurorisë.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, mbrojtja thekson se Gjykata e shkallës së parë si pasoj e shkeljeve shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe me shkeljes nga neni 361.2 të KPP-së, gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike të përfshirë në pikën II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, përkitazi me veprimet e të akuzuarit A.G..

Sipsa mbrojtjes vërtimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike qëndron në atë së Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar se i akuzuari A.G. ka ndihmuar të akuzuarit të ndjerin N. C., XH.S. dhe I.S. që të vënë në lajthim zyrtarët e zyrës për regjistrim civil në Prishtinë dhe Obiliq me rastin e aplikimit të tyre për dokumente identifikimi, përkatësisht, ka vjedhur dhe i ka siguruar të tashmë të ndjerit N. C. identitet të rremë me të dhënat L.Sh., shtetas i Republikës së Kosovës, i lindur më 08.01.1979 në Resnik, ka vjedhur dhe i ka siguruar të akuzuarit I.S. identitet të rremë me të dhënat M.Gj., shtetas i Republikës së Kosovës, lindur më 29.12.1982 në Bukosh, ka vjedhur dhe i ka siguruar të akuzuarit XH.S. identitet të rremë me të dhënat S. Sh. shtetas i Republikës së Kosovës, lindur më 18.02.1950 në fshatin Sheremet, i ka siguruar tashmë të ndjerit N. C., ekstraktin e lindjes me identitet të rremë të shtetasit Lj.Sh., i ka siguruar të akuzuarit I.S. ekstraktin e lindjes me identitet të rremë të shtetasit M.Gj. i ka siguruar të akuzuarit XH.S. ekstraktin e lindjes me identitet të rremë të shtetasit S.Sh., ka shoqëruar të akuzuarit XH.S. dhe I.S. në qendrën e regjistrimit civil në Prishtinë dhe Obiliq, ka siguruar nxjerrjen e dokumenteve të identifikimit për të akuzuarit XH.S. dhe I.S. përmes një shoku të tij, person zyrtar, i cili për më tepër nuk është identifikuar dhe as dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Lidhur me shkeljen e ligjit penal, thekson se shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i faktike, kanë rezultuar domosdoshmërisht edhe në shkeljen e ligjit penal në dëm të akuzuarit A.G., siç përcaktohet me nenin 385.1, nënpar. 1.1 i KPP-së, sepse veprimet e përshkruara në pikën III të dispozitivit të atakuar nuk përbëjnë figurën e veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale legalizimi i përmbajtjes së rreme, të sanksionuar nga neni 403, par. 2), lidhur me par. 1 dhe nenin 33 të K.PRK për të cilën i njëjti është shpallur fajtor dhe dënuar.

Gjykata e shkallës së parë ka dështuar që të masë dënimin konform neneve 73-75, lidhur me nenin 33 të KPRK-së pasi nuk ka zbatuar dispozitat e zbutjes së dënimit dhe se sanksioni penal

mund të zbutet për maksimum deri në 30 (tridhjetë) ditë burgim, ndërsa në rastin konkret Gjykata e shkallës së parë e ka dënuar të akuzuarin A.G. me një vit burgim efektiv, pa dhënë shpjegim se përse nuk ka matur lartësinë e sanksionit penal konform dispozitave në fjalë.

3. Gjetjet e Gjykatës së Apelit

3.1. Të gjeturat për shkelje esenciale të dispozitave të KPP-së

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat, sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar. Gjykata e Apelit, gjen se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të mbrojtësve se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, në pajtueshmëri të plotë edhe me arsyetimin dhe përpilimin e dispozitivit.

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale-juridike, duke vepruar konform dispozitave të nenit 370 par. 6 të KPP-së, gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit dhe atë si ato faktike dhe ato juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Kolegji vlerëson se ankesa e Prokurorisë Speciale është e pabazuar dhe nuk qëndrojnë pretendimet për vërtetimin e përgjegjësisë penale për të akuzuarin A.G. për veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par. 2 lidhur me par, 1 të KPRK-së. Kolegji pajtohet me arsyet e dhëna në aktgjykim në raport lirimim nga akuza për këtë veprë penale, në rrethanat e çështjes rezultojnë se nuk ekzistojnë prova dhe dëshmi bindëse të cilat do të vërtetonin se i akuzuari A.G., e ka përpiluar dokumentin e falsifikuar, autorizimin për veturën BMW, se ka ndryshuar dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ose me dije e përdor dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar si origjinal, mbi bazën e fakteve të

vërtetuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk janë provuar përtej dyshimit të bazuar mirë tiparet inkriminuese të kësaj vepre penale, rrjedhimisht gjykata me të drejt e ka liruar nga akuza.

Në aktgjykimin e atakuar gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësimin e provave në pajtim me dispozitat e nenit 361 par.1 të KPP-së, duke dhënë arsye të qarta dhe konkrete për besueshmërinë e tyre, si të dëshmimeve të dëshmitarëve ashtu edhe të provave materiale, dhe më pas ka bërë ndërlidhjen tyre. Rrjedhimisht, ankesat e mbrojtësve se nuk përmbajnë arsye për faktet dhe rrethanat vendimtare si të tilla janë të paqëndrueshme.

Gjykata dëgjoi dëshminë e dëshmitarit A.S., zyrtar policor që në këtë çështje ka qenë edhe hetues i rastit, e që bazuar në punën hetimore kishin informacione për një grup kriminal që merret me krimin e organizuar lidhur me shitblerjen dhe transportin e narkotikëve, trafikimin ndërkombëtar. Në vitin 2017 identifikuan si të dyshuar të akuzuarit XH.S., S.SH. I.S. dhe L.N., që më vonë u kuptua se L.N. ishte tani i ndjeri N. C.. Ky dëshmitar shpjegoi se bëhej fjalë për sasi të madhe të narkotikut të llojit heroinë, që pritej për tu transportuar nga Turqia përmes Shqipërisë e që kjo u dëshmuar edhe me provën materiale ku në banesën e të ndjerit u gjetën 113 kg, narkotik të llojit heroinë.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit Xh.SH., av.Asdren Mekaj, se aktgjykimi është kontradiktor mes përmbajtjes së dispozitivit dhe arsyetimit, nuk është i konkretizuar se në çka konsistojnë këto kundërthënie, për Kolegjin aludimet e tilla janë të pa specifikuar dhe të pa qarta. Po ashtu pretendimet se aktgjykimi bazohet në transkriptin e përgjimeve dhe se përveç listimit të tyre nuk jep sqarime, janë të paqëndrueshme, në aktgjykim ekzistojnë interpretime dhe sqarime e duhura, dhe janë dhënë sqarime për ndërlidhjen me veprimet inkriminuese të akuzuarve.

Pretendimi se kemi të bëjmë me prova të papranueshme nuk është i qëndrueshëm, gjykata aktgjykimin e mbështetë në dëshminë e dëshmitarëve të dëgjuar drejtpërdrejtë dhe në provat materiale, nuk specifikohet se në cilin raport policor të evidentuar konkret mendon mbrojtja, prandaj theksimi se aktgjykimi i shkallës së parë është i bazuar në prova të papranueshme që tërheq pas vetes shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 1.8 lidhur me nenin 259 par. 1 dhe 337 par.2 dhe 338 par. 1 të KPP-së rezulton të jetë i pabazuar.

Gjithashtu, në ankesë theksohet se ekziston vendimi i Gjykatës së Posaçme për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar i Republikës së Shqipërisë, me nr. 8 i datës 04.02.2022 me të cilin i

akuzuarit Xh.SH. dhe I.S. janë shpallë fajtor dhe janë dënuar dënim unik prej 15 vjet në mungesë, Kolegji vëren se vendimi ka të bëjë me aktivitetin e trafikimit të narkotikëve që lidhen me Republikën e Shqipërisë me një grup të madh personave dhe për sjelljen e lëndës së parë për prodhimin e heroinës dhe kokainës në Shqipëri lidhur me laboratorin drogës në Has, në këtë kontekst nuk ekzistojnë të dhëna që përfshihet edhe trafikimi i substancës narkotike që është objekt i kësaj çështje.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.SH., av.Naim Rudari, në ankesë konsideron se aktgjykimi bazohet në provë të papranueshme sepse bazohet në dëshmitë e rrejshme të dy të dyshuarave M.K. dhe E.B..

Kolegji çmon se mbrojtësi në këtë mënyrë ngritë çështjen e besueshmërisë së dëshmitarëve, dhe jo çështjen e papranueshmërisë së provave, aludimi se dëshmitë janë të rrejshme dhe për këtë arsye janë prova të papranueshme nuk gjen mbështetje ligjore, pasi që provat e papranueshme janë prova të cilat janë marrë në kundërshtime me dispozitat ligjore, të cilat nuk ndërlidhen me aspektin e besueshmërisë, objektivitetit dhe vërtetësisë të cilat komponentë i vë në pikëpyetje mbrojtësi. Si dhe pjesa ankimore në të cilën theksohet se aktgjykimi bazohet në paragjykime është i paqëndrueshëm, meqenëse aktgjykimi bazohet në dëshmitë dhe provat konkrete me të cilat vërtetohet roli, veprimi dhe aktiviteti i sinkronizuar i të akuzuarve, dhe se nuk kemi të bëjmë me supozime dhe paragjykime.

Po ashtu lidhur me pjesën e ankesës se pse M.K. e ka statusin e dëshmitares dhe për këtë gjykata nuk ka dhënë arsye, sipas këndvështrimit të Kolegjit këtë çështje nuk e përcakton gjykata, është detyrë e prokurorisë që në mënyrë të pavarur të përcaktoj se kush do të jenë të akuzuar dhe dëshmitarë në një çështje konkrete penale.

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit I.S., av.Halim Kuliqi, ka theksuar se aktakuza është ndërtuar mbi bazën e dëshmive të A.S. hetues i krimi të organizuar me narkotikë, i njëjti ka deklaruar se nga koha 18 nëntor 2017 grupi kriminal i strukturuar kanë qenë nen masat e vëzhgimit dhe përgjimit, dhe se nuk janë siguruar prova për këtë, dhe prokuroria dhe gjykata kanë vepruar me dyshime dhe kjo përbënë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që aktgjykimi është bazuar në prova të pa papranueshëm dhe për këtë duhet të anulohet.

Sipas Kolegjit, ankimi se kemi të bëjmë me prova të papranueshme se “gjykata dhe prokuroria mbështetet në dyshime dhe jo në prova, dhe se kjo paraqet mbështetja në prova të papranueshme” është e

pakuptueshme, koncepti i provave të papranueshme duket se nuk është kuptuar drejtë nga mbrojtësi dhe konceptohet ndryshe çka paraqesin në të vërtetë.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit A.G. av. Besnik Berisha, se kemi të bëjmë me tejkalim të akuzës, pasi i akuzuari është shpallë fajtor për një vepër tjetër penale nga ajo që është akuzuar dhe mbi një përshkrim tjetër të fakteve.

Kolegji vëren se i akuzuari A.G. është akuzuar për veprën penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale nga neni 398 par.1. lidhur me par.2.8 të KPRK-së, për të cilin kualifikim ka mbetur prokurori në fjalën përfundimtare, ndërsa është shpallë fajtor nga gjykata për veprën penale legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 403 par.1 të KPRK-së.

Fillimisht duhet qartësuar se të dy veprat penale bien në kapitullin XXXII të veprave penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike. Vepra penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale nga neni 398 par.1. lidhur me par.2.8 të KPRK-së është sanksionuar me dënim burgimi prej 6 muaj deri në 5 vjet, ndërsa vepra penale legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 403 par.1 të KPRK-së e dënueshme prej 3 muaj deri në 5 vjet.

Gjykata me rastin e ri cilësimit juridik të veprës penale ka vepruar në kapitullin e njëjtë të veprave penale, që nënkupton ka mbetur në njëllojshmërinë e veprave penale brenda kuadrantit të fakteve të përfshira në aktakuzë e të provuara në shqyrtimin gjyqësor, si dhe bëhet fjalë për një vepër penale të sanksionuar më dënim më të ulët në krahasim me veprën penale sipas kualifikimit në aktakuzë, për rrjedhojë, gjykata ka tagër që të veproj brenda kësaj kornize në raport me kualifikimin juridik, duke i'u dhënë fakteve të provuara në aktakuzë cilësimin e duhur ligjor pa cenuar identitetin dhe natyrën e veprave penale, kuadrin e fakteve dhe mos kualifikimin për një vepër penale më të rëndë.

Po ashtu, aktgjykimi atakohet edhe për faktin se konsideron se janë cenuar dispozitat e tjera të theksuara në ankesë, Kolegji i trajtoi si të pabazuara, nga faktet e çështjes rezulton se i akuzuari ka pasur të drejtat gjatë zhvillimit të procedurës penale dhe shqyrtimit gjyqësor për ti vënë në pyetje deklaratimet e mëparshme të bashkë të akuzuarve dhe dëshmitarëve. Në këtë aspekt gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet e duhura lidhur me arsyetimin e fakteve dhe rrethanave vendimtare që kanë të bëjnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, mënyrën e të provuarit të veprimeve inkriminuese të cilat i aprovon edhe kjo Gjykatë.

3.2. Të gjeturat lidhur me pretendimet për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike

Në raport me pretendimet ankimore për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton që gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për faktin se me provat administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se të akuzuarit XH.S., S.SH. dhe I.S. shtetas turk, duke vepruar si pjesëmarrës të grupit kriminal të strukturuar dhe të organizuar mirë i shtrirë në territorin e disa shteteve, Iran, Dubai, Shqipëri, Kosovë edhe me të akuzuarin - tani i ndjeri N.C., i cili ishte në krye të këtij grupi të organizuar kriminal, kishin organizuar transportin e 113 kilogram heroinë nga Irani. Duke e transportuar nga Irani -Dubai - Durrës dhe më pas me maune në depon e firmës së të akuzuarit S.SH. –“S.SH. B.I: me seli Ferizaj, të cilën e kishte regjistruar me datë 14.02.2017 në emër të tij, depo e marrë me qira nga S.M., ku gjatë viteve 2017-2018 në emër të firmës ka eksportuar gjithsejtë 19 maune me pllaka të mermerit dhe gurë dekorues ku në eksportin e fundit me datë 13.10.2018, përmes firmës janë eksportuar 6 maune me pllaka të mermerit, me ç’rast në njërën nga maunet, në 10 paketime të pllakave në secilën prej tyre kishte nga dy bunkerë ku ishte e vendosur substanca narkotike e llojit heroinë me peshë bruto prej 113 kg, e cila substancë është gjetur dhe sekuestruar në banesën e të ndjerit në Prishtinë.

Gjendjen e tille faktike gjykata e ka vërtetuar nga dëshmitarët: A.S.; M.K.; E.B.; I.H.; S.M.; I.C.; B.B. F.P.; B.Sh.; A.Z.; M.M. dhe F.M.;

Provat materiale: Kontrata për qira e lidhur në mes të XH.S. dhe S.M. me numër Lpr.nr.9123/2018, me Ref.nr.3110/2018 e dt. 12.07.2018; Transkriptat e bisedava të përgjuara telefonike mes të pandehurve; përmbajtja e sms dhe thirrjet telefonike mes të pandehurve, për vitin 2018, me raportet policore përkatëse; raporti informues – përmbledhës i dt. 12.07.2019 lidhur me përgjimet; raportet e policisë për fotografimin e fshehtë ose vëzhgim me video dt.19.10.2018; 30.10.2018; 31.10.2018; 01.11.2018; 05.11.2018; 06.11.2018 dhe 07.11.2018; 4 CD të fotografimit të fshehte ose vëzhgim me video; 3 CD të marra nga kamera e sigurisë së objektit C2, Llam C – Prishtinë; Raporti njoftues mbi bastisjen, e dt.03.12.2018 së bashku me raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe fotoalbumi i datës 02.12.2018 dhe vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve në banesën e të ndjerit N.C.; Raporti i autopsisë së trupit të ndjerit N.C datë 29.03.2019 nga Mjekësia Ligjore nr. MA18-346; raporti informues mbi bastisjen dt. 26.03.2019 me procesverbalin mbi bastisjen e banesës dhe personave me vërtetimin mbi sekuestrimin e sendeve të A.G.; Raportet njoftuese mbi bastisjen dt.03.12.2018; 17.12.2018 dhe 26.12.2018 të banesave të marra me qira nga i akuzuari XH.S.; Vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve dt.02.12.2018 dhe 03.12.2018 nga i

akuzuari S.SH.; raporti i bastisjes i dt.03.12.2018 dhe fotoalbumi i vendit të ngjarjës në depon dhe oborrin e deposë në Ferizaj, rruga “Nora Kelmendi”, pa nr; Vërtetimi për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve 03.12.2018 nga i akuzuari I.S. (M.G.; Vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, dt.08.12.2018 lidhur me sekuestrimin e BMW-së, nga S.Ç. dhe vërtetimi mbi kthimin e sendeve; Përgjigja e autoriteteve të Shqipërisë dt.15.02.2019; Kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare - Autoriteteve të Shqipërisë; Raporti i ekspertizës nga Drejtoria e Teknikës Kriminalistike IT dhe raporti infomues i policisë mbi ekzaminimin e telefonave dt.30.05.2019; Raportet të ekspertimit nga AKF dt.03.07.2019; raporte të ekspertimit nga AKF dt.25.02.2019; Autorizimi i falsifikuar me nr.Lrp.nr.229/2018 me numër reference 311/2018, e lëshuar në emër të noteres F.P. në Pejë; Dokumente doganore lidhur me zhdoganimin e mauneve me pllaka të mermerit dt.13.10.2018; Aktgjykimi i Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Vendimi nr.8 i datës 04 shkurt 2022, si dhe gjykata ka bërë edhe administrimin e deklaratave të të akuzuarve –mbrojtjen e tyre të dhënë gjatë fazës së hetimeve në polici dhe në prokurori, të akuzuarve XH.S., S.SH., I.S. dhe A.G..

Si fakt i pakontestueshëm rezulton se në banesën e të ndjerit N. C. janë gjetur dhe sekuestruan tri valigje të mbushura me narkotikë të llojit heroinë me peshë të përgjithshme prej 113 kg, ndërsa nga ekspertiza nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë është konstatuar se narkotiku është i llojit heroinë.

Sasia e narkotikut ishte kamufluar në pllakat e mermerit, të cilat janë blerë në Republikën Islamike të Iranit prej nga edhe janë sjellë në Republikën e Kosovës e kjo provuar nga provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në 10 paketime të pllakave të mermerit janë hapur dhe janë vërejtur se në mesin e atyre paletave janë hapur bunker, dhe aty është vendosur sasia e narkotikut, e cila më pas nga të akuzuarit është nxjerr prej aty dhe është sjell në banesën e të ndjerit N.it, ku edhe është gjetur.

Dëshmitë kanë vërtetuar se narkotiku ishte sjell në banesën e të ndjerit gjatë muajit tetor, ndërsa është gjetur dhe sekuestruar me datë 02 dhjetor, ndërsa në banesën tjetër po ashtu të marrë me qira e që gjendej në Fushë Kosovë në ndërtesën e spitalit “Euromed”, u gjetën dhe sekuestruan 1 qese me substancë narkotike të llojit heroinë, valigje të zbrazëta si dhe gjësende të tjera të cilat ishin shfrytëzuar për përpunimin dhe paketimin e narkotikut.

Nga dëshmia e dëshmitarit A.S., gjykata vërtetoi faktin se i njëjti ishte zyrtar policor dhe në këtë çështje edhe hetues i rastit, e që bazuar punës hetimore kishin informacione për një grup kriminal që merret me krimin e organizuar lidhur me shitblerjen dhe transportin e narkotikëve, trafikimin ndërkombëtar ku në vitin 2017 identifikuan si të dyshuar të akuzuarit XH.S., S.SH. I.S. dhe L.N., që më vonë u kuptua se L.N. ishte tani i ndjeri N. C.. Ky dëshmitar ka vërtetuar, se bëhej fjalë

për sasi të madhe të narkotikut të llojit heroinë e që pritej për transportin nga Turqia përmes Shqipërisë e që kjo u dëshmuar edhe me provën materiale ku në banesën e të ndjerit u gjetën 113 kg, narkotik të llojit heroinë.

Nga dëshmia e dëshmitarit, gjykata ka vërtetuar se gjatë mesit të muajit tetorit të vitit 2018, të akuzuarit kishin shkuar në Shqipëri, dhe me tu kthyer nga Shqipëria kanë kuptuar se në Shqipëri autoritetet shqiptare kishin zbuluar një laborator të drogës në Has të Shqipërisë dhe ishin publikuar emrat e personave të implikuar të atij rasti e ku në mesin e tyre ishin përmendur edhe emrat e të akuzuarve XH.S., I.S. dhe Lavdimi (N.i).

Fakti për publikimin e emrave të tyre është vërtetuar pa mëdyshje edhe nga bisedat e përgjuara telefonike, të akuzuarit përmes telefonit kanë biseduar se iu dolën emrat dhe se duhet ti ndërrojnë numrat e telefonit, ti gjuajnë dhe se tani interesohen për gjetjen e personave për ndërrimin e identiteteve dhe ishte kjo një kthesë që edhe ishin vështirësuar hetimet e rastit ngase të akuzuarit, tani ishin më të kujdesshëm në lëvizjet e tyre si dhe kishin filluar me ndërrimin e veturave të cilat i kishin pasur.

Dëshmitari ka vërtetuar se bazuar informacioneve dhe hetimeve nga masat e fshehta dhe bisedave të përgjuara telefonike dhe hartografisë kishin vërtetuar se të akuzuarit kishin një depo në Ferizaj, ishin duke e përgatitur ose ishin duke e marrë drogën nga depoja, ngase derisa ishin në atë depo gjatë bisedave mes të akuzuarve kanë përmendur fjalët “vajzat, dritaret”, “katër i kemi hap tash të pestën e kemi hap”, ndërsa pas identifikimit të vendndodhjes së depos është konstatuar se në atë depo kishte pllaka të mermerit, ku me ata gur edhe ishte importuar droga nga Irani në depo dhe se kanë vërtetuar faktin se veprimtaria ishte e regjistruar në emër të S.SH., firmë për import të mermerit nga Irani në Kosovë, vendi i nisjes Iran-Dubai-Durrës-Kosovë.

Dëshmitari ka shpjeguar se pas publikimit të emrave të tyre në Shqipëri, menjëherë të akuzuarit filluan për gjetjen e njerëzve dhe mundësinë për ndërrimin e identiteteve të vërtetë në aspektin e ligjshëm me vjedhje të identitetit edhe kontaktin e parë fizik para qendrës së regjistrimit në Prishtinë gjatë muajit tetor 2018, XH.S., I.S. dhe Lavdimi e kishin me A.G.. Dëshmitari ka vërtetuar faktin se i kishte dëgjuar në atë takim duke përmendur fjalë pasaportë, më pas edhe i kishin frekuentuar Qendrat e regjistrimit në Prishtinë dhe Obiliq, ku edhe në atë kohë kishte ndërruar identitetin edhe L1., në L. dhe të akuzuarit arritën që të siguronin identitetet e reja, duke u pajisur me letërnjoftimet dhe pasaportë.

Dëshmitari vërtetoi se të akuzuarit, kryesisht i akuzuari Xh.SH. dhe A.G. kishin komunikime telefonike si dhe takime, të njëjtat janë dëshmuar edhe me foto meqë ishin nën masën e përgjimit dhe vëzhgimit dhe biseda të përgjuara dhe të gjitha kontaktet edhe për të akuzuarin I. edhe për të ndjerin N. ishin realizuar me A. përmes Xh..

Dëshmitari ka vërtetuar se i akuzuari I. kishte qëndruar më shumë te N.i se tek baba i tij, ndërsa në këtë grup si persona kyç ishin N.i dhe Xh., S. ishte pronar i firmës përmes të cilës firmë edhe ishte bërë transporti i drogës.

Dëshmitarit ka vërtetuar gjendjen faktike se mermeri ishte porositur nga firma e të akuzuarit S., në Kosovë ka ardhur përmes portit të Durrësit dhe narkotiku - heroina kishte ardhur përmes mermerit-pllakat e mermerit, ku gjatë kontrollit dhe bastisjes së depos në bazë të paketimit ishin paleta të vjetërsuara brenda të mbushura me pllaka mermeri e disa të hapura 5 apo më shumë të hapura, ku pllakat ishin të prera në pjesën e brendshme derisa nga biseda e mëhershme në mes të I. dhe Xh. dhe asaj çfarë kanë parë në depo është vërtetuar se me pllakat e mermerit ka ardhur droga, derisa në ditën e vikendit me dy automjete kishin shkuar në Ferizaj, Xh., L. (N.i) një person tjetër i cili e lajmëron Xh. në telefon mos u ngut ka polic, përshtatju shpejtësisë nga e cila bisedë është kuptuar se I. nuk ka qenë në të njëjtën veturën me Xh., pasi që I. i tregon se kah duhet të shkoj me fjalët “atje nalt ku jemi ne“, dhe ishte kjo koha kur të akuzuarit e kanë marrë drogën nga depoja dhe e kanë dërguar në banesën e të ndjerit.

Pretendimet e mbrojtësit se Asdren Hoxha se nuk është provuar se i akuzuari Xh.SH. të ketë qenë i përfshirë në transportin e narkotikëve dhe gjykata lidhur me këtë konkludimet nuk i mbështet në prova konkrete, është i padrejtë, Kolegji, do të citoj vetëm disa nga fragmentet e bisedave të zhvilluara nga i akuzuari Xh. që provojnë implikimin e tij në këtë aktivitet kriminal.

Me datë 13.10.2018, në ora 15:46:31 Xh. kontakton I. ku flasin në gjuhën turke, ku Xh. pyet “Alo çka po bani?”, I. “Valla kurgjo, jemi n punë duke punuar, të thërras unë ty babë edhe pak, edhe pak ka mbete“, Xh. “Në rregull shihemi“, I. “Edhe pak ka mbet, hajt shihemi“, më pas Xh. pyet ”Sa vajza shkuan“, I. ”E katërta, 4 po kryhet“, “Dritarja e katërt po kryhet“, Xh. “E katërta 4 a?”, I. “Dritarja e katërt po përfundon, bile edhe të pestën jemi duke e përfundu“, Xh. “Valla, mirë po i paloni a“, I. ‘Hajt babë shihemi, të thërras unë ty‘.

Nga kjo bisedë vërtetohet, momenti kur I. dhe N.i kanë nxjerr narkotikun nga bunkerët e krijuar në mes të pllakave të mermerit, e që të akuzuarit kanë përdorur kode si “vajzat, dritaret”, është mëse e qartë se në atë depo, nuk kishte vajza, e as vajzat nuk palohen, biznesi i tyre nuk ishte

marrë me dritare, por që në fakt pllaka ishin prerë në mes dhe janë krijuar dritare, formë e dritarës dhe I. i tregon Xh.t se është në punë, po punojnë.

Kurse me datë:14.10.2018 ora 11:43:32 I. kontakton Xh.in të cilit i thotë: "Atë ditë që kemi ngrëne bukë, unë me ty dhe R. aty vini", Xh. "Në superViva ", I. "Po", kurse në ora 16:12:52 I. kontakton Xh. në gjuhën turke, I. "Ku je", Xh."Kam hyrë në rrugë të Prishtinës, kah shkon kah ju", I. " Aha, hajt se shihemi ", ndërsa në ora 16:24:20 Xh. kontakton I. në gjuhën turke, I. "He mustaqe", Xh. "Ku je" I. "Erdhëm për një minute jemi aty", Xh. "E parkova këtu, ku e kam parkuar në mëngjes", I. "A zbritë poshtë ti ", Xh. " Jo, jo ", I. "Në rregull për 10 sekonda jemi aty".

Antena tregon lokacionin Prishtina Ambulanta 1, Prishtina Spitali 2 – Rruga B, nga kjo bisedë e cila është e datës kur është bërë transporti i narkotikut nga depoja në Ferizaj në Prishtinë në banesën e të ndjerit N., në bazë të bisedave të zhvilluara Xh. ka qenë duke e drejtuar veturën e tij Audi A6, duke shkuar te banesa e N.it ku edhe bisedon me I., ndërsa N. së bashku me I. në veturën Mercedes të N.it, derisa S. me A1., ku edhe e ka vërtetuar biseda kur A1. e telefonon Xh. dhe i thotë të vozit aq sa është se po e nxen radari.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit avokat Naim Rudari në raport me gjendjen faktike, Kolegji i gjen të pabazuara, se aktgjykimi bazohet në dëshmitë e rrejtshme të dëshmitarëve M.K. dhe E.B. dhe se aktgjykimi është bazuar paragjyqime dhe se gjykata vetëm për ta përmbushur kushtin e tre personave për ti futur grupin kriminal të organizuar është dashur detyrimisht që të shkruan edhe diçka për S.Sh., edhe pse për të njëjtin nuk është argumentuar me asnjë provë se ai ka ditur që në banesën e N. C. kishte narkotike dhe se nuk vërtetohet se S. Sh. së paku një herë t'i ketë shitur dikujt substanca narkotike apo të këtë ndihmuar ndokënd për të shitur substanca narkotike e aq më pak ë këtë qenë pjesë e ndonjë grupi kriminal të organizuar.

Kolegji gjen se aktgjykimi i atakuar mbështetet jo vetëm në dëshmitë e dëshmitarëve të sipërcekura, dëshmitë e të cilave kanë mbështetje edhe në dëshmitë dhe provat e tjera, por edhe në provat e tjera materiale të cilat pa mëdyshje implikojnë të akuzuarin S.Sh. të shpjeguara në aktgjykimin e atakuar, në sigurimin e regjistrimit të ndërmarjes së tij për importimin e pllakave të mermerit dhe shfrytëzimin e këtij biznesi për të kamufluar aktivitetin e trafikimit të substancës narkotike nga Irani.

Dëshmitari vërteton se ditën kur ishte gjetur i vdekur N., në banesën e tij ishin M.K., E.B. dhe S.SH. dhe nga biseda e përgjuar telefonike të asaj date me telefonin e S.t i cili ishte nën përgjim, vërtetohet pa mëdyshje se për çështjen e drogës ishin në dijeni S., M. dhe shoqja e saj E., nga

biseda e M. dhe E., qartë u vërtetua se dinin se substanca narkotike gjendej aty. Po ashtu vërtetohet se S. nuk lejonte që ftohet ndihma emergjente për ti dhënë ndihmë tani të ndjerit, nga frika e zbulimit të narkotikëve të cilat fakte në lidhmëri me faktet se ishte pronar i firmës, depoja dhe malli me dokumentacion në emër të tij, çelësat e depos të përbashkët, shitje të mermerit shumë pak ose hiq ngase nuk kishte shitje për pllaka dhe nuk kishte interesim për shitje, rrjedhimisht rrethanat e tilla në ndërlidhjen e tyre japin pasqyrën e plotë e të qartësuar të përfshirjes, aktivitetit dhe dijenisë të këtij të akuzuari në mënyrë të padiskutueshme.

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit I.S., av.Halim Kuliqi thekson se nuk është provuar përgjegjësia penale e të akuzuarit S.S., për faktin se as dëshmitarët e dëgjuar dhe provat e tjera nuk dëshmojnë ndonjë fakt inkriminues për të. Kolegji çmon si të paqëndrueshme për faktin se nga provat materiale në veçanti të cituara më lartë, konstatohen komunikimet e të akuzuarit I. me të akuzuarit e tjerë për lidhur me trafikimin, transportin e sasisë në depo, hapjen dhe transportin për në Prishtinë në banesën e tani të ndjerit N.C..

Kolegji i vlerëson si të pabazuara pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit A.G., avokat Besnik Berisha, për faktin se dëshmitë dhe provat e procedura konstatohet kontakte dhe veprimet e të akuzuarit në sigurimin e dokumenteve për ndërrimin e identitetit të akuzuarve, fragmenti i bisedës më poshtë, pasqyron qartësisht veprimet e të akuzuarit:

Biseda në mes të akuzuarve A.G. dhe XH.S. me datë 26.10.2018 ora 16:00:02 A. "Alo çka bane shef", Xh. "Kurgja ai e murr", A. "Dëgjo një minutë, a ke kry pune ti me djalë a ", A. "Pse i ke thanë këtij shokut tem kam kry punë vëlla ". Ku me datën 25.10.2018 shtetasit Turk N. C., tani i ndjerë, nga MPB, i është lëshuar letërnjoftimi dhe pasaporta e R. Kosovës me të dhënat Lj.Sh.-identitet te rrejshëm, ku në bazë përgjimeve, nga bisedat mes Xh. Sh. dhe A.G., është kuptuar se me datë 26.10.2018 N. C. është pajisur, ka pranuar dokumentacionin në fjalë, sipas instruksioneve që ja ka dhënë i akuzuari A.G., të akuzuarit XH.S., person i afërt me N..

Për rrjedhojë, nga arsyet e shpjeguara më lartë Kolegji arrin në përfundimin se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike.

3.3. Të gjeturat lidhur me pretendimet për shkelje të ligjit penal

Mbrojtësit e të akuzuarve, Xh.SH., av.Asdren Mekaj, S.SH., av.Naim Rudari, I.S., av.Halim Kuliqi, kanë paraqitur arsyet ankimore se në rastin konkret nuk plotësohen kriteret për ekzistimin e krimit të organizuar duke theksuar se mungon elementet për tu kualifikuar veprimet e të akuzuarave vepër penale e krimit të organizuar pasi të akuzuarit janë familjar mes vete.

Kolegji gjen se organizimi i të akuzuarve në kryerjen e veprës penale të transportimit të narkotikëve tregon për nivelin e organizimit të lartë, të grupit për strukturën dhe nivelin e kontrollit që dëshmohet që kishte tani i ndjeri shtetasi turk N. C. në tërë aktivitetin kriminal dhe lojalitetin e pakontestueshëm që kishin të akuzuarit ndaj tij, që konstatohet nga komunikimet dhe nga masat e vëzhgimit.

Fakti i organizimit të transportit nga Irani- Dubai-Durrës - Ferizaj, mënyra se si janë kamufluar në bunkerë dhe në të cilat nuk mund të detektohen as nga skanerët që përdoren në portet detare për ti kontrolluar dërgesat, kontinerë dhe maunet për qëllim të parandalimit të aktivitete të trafiqeve të tilla, në këtë kontekst edhe fakti se ndaj të akuzuarve dhe tani të ndjerit kishin filluar hetimet dhe ishin lëshuar masat e ndalimit nga Gjykata e Tiranës për Krim të Organizuar dhe Korrupsion për përfshirjen në aktivitetin e trafikimit të narkotikëve duke përfshirë laboratorin e drogës të zbuluar në Hasë të Republikës së Shqipërisë, ndërrimi i identitetit praktikë e aplikuar nga pjesëtarët e grupeve kriminale të organizuara, si dhe vendimin e kësaj ndërsa nga Aktgjykimi i Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Vendimi nr.8 i datës 04 shkurt 2022, të akuzuarit XH.S. dhe I.S. janë shpallur fajtor për vepra penale të trafikimit të narkotikëve dhe u është shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 15 viteve.

Të gjitha këtë fakte në unitetin e tyre tregojnë se kemi të bëjmë me grup kriminal i cili karakterizohet me strukturë të qëndrueshme hierarkike dhe kohezive, aktiviteti i të cilit ishte trafikimi i substancave narkotike, me dimension dhe karakter ndërkombëtar dhe ndërkontinental, andaj Kolegji ndan pikëpamjen e njëjtë me të gjykatës së shkallës së parë që mbi këto fakte të provuara formësohen tiparet e veprës penale pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par. 1 të KPRK-së, lidhur me veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge të sanksionuar nga neni 273 par. 2 i KPRK-së.

Të gjeturat për vendimin mbi dënimin

Duke vlerësuar çështjen për vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e mbrojtëseve të akuzuarve për një dënim me të butë dhe prokurorit për dënim më të lartë janë të pa bazuara.

Kolegji pajtohet pjesërisht me vlerësimin e rrethanave për përcaktimin e dënimit të përcaktuar nga gjykata, megjithatë vlerëson se fakti se të akuzuarit kanë vepruar si pjesëtar të grupit kriminal të organizuar nuk mund të vlerësohet si rrethanë rënduese, në situatën kur janë shpallur fajtor për veprën penale e cila është kualifikuar si krim i organizuar, ngase kjo do të nënkuptonte dyfishim i aplikimit të rrethanave rënduese nga ligjvënësi dhe pastaj nga gjykata me rastin e zbatimi të tij.

Shkallën e përgjegjësisë penale, varësisht pjesëmarrjes dhe rolit të akuzuarve në kryerjen e veprës penale, gjykata për të akuzuarit bazuar në këtë rrethanë ka shqiptuar dënim më të ashpër të akuzuarve Xh.SH. dhe I.S. në krahasim me të akuzuarin S.SH., ngase të akuzuarit Xh. dhe I. në raport me të akuzuarin S. ishin më shumë të involvuar në kryerjen e veprës penale të narkotikut, ngase provat kanë vërtetuar se i akuzuari XH.S. dhe i ndjeri N. ishin personat vendimtar, i akuzuari I. ishte personi më i afërt me të ndjerin N., derisa i akuzuari S. po ashtu në raport me të ndjerin kishte më së paku lëvizje, por që bashkërisht e kanë transportuar narkotikun nga depoja në Ferizaj në Prishtinë si dhe faktin se narkotiku trafikuar nën ombrellën e firmës së tij. Po ashtu rrethanë rënduese duhet të vlerësohet sasia e narkotikut, në këtë rast të akuzuarit kanë transportuar – trafikuar sasinë në peshë të përgjithshme prej 113 kg e 507 gram e llojit heroinë.

Kolegji pajtohet me vlerësimin e rrethanave lehtësuese si pranimin e fajësisë për veprën penale, legalizimi i përmbajtjes së rreme nga të akuzuarit Xh.SH. dhe I.S., sjelljen e mëparshme të kryesve për të gjithë të akuzuarit cilët nuk janë të dënuar më herët për vepër penale, në bazë të dhënave që posedon gjykata për këta të akuzuar, nuk është vërtetuar se kanë rënë ndesh me ligjin më herët, respektivisht nuk janë dënuar me aktgjykim të formës së prerë, apo të kenë vuajtur ndonjë dënim.

Në raport me të akuzuarin A.G. dënimi i shqiptuar është proporcional në relacion me rrethanat rënduese dhe lehtësuese, pretendimet e mbrojtësive se nuk janë aplikuar dispozitat për zbutjen dënimit Kolegji i vlerëson të pabazuara, pasi në rrethanat e çështjes që i referohen veprës penale dhe personalitetit të akuzuarit nuk ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit dhe se zbutja e

dënimit është përjashtim nga limitet ligjore mes minimumit dhe maksimumit të dënimit e cila justifikohet vetëm në situatat e ekzistimit të rrethanave.

Për rrjedhojë, Kolegji çmon në bazë të rrethanave të lartë cituara të akuzuarve janë shqiptuar dënime proporcionale dhe të justifikueshme në relacion me peshën konkrete të veprës penale, rrethanave të kryerjes, shkallën e përgjegjësisë penale, dhe se me këtë dënime arrihet efekti preventiv i dënimit, respektivisht që në të ardhmen të përmbahen nga kryerja e veprës - veprave penale të këtilla dhe se në kuptim të preventivës gjenerale që të përmbahen persona tjerë nga kryerja e veprave penale, në këtë kontekst pretendimet e prokurorit për dënim më të ashpër dhe të mbrojtësve për dënime më të buta janë të pabazuara nga arsyet e cekura më lartë.

4. Përfundimi

Kolegji arriti në përfundimin se ankesat e Prokurorisë Speciale dhe e mbrojtësve të akuzuarve janë të pabazuara në të gjitha bazat ankimore dhe se aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special PS.nr.67/19 i datës 27.09.2022, nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe as të dispozitave për matjen e dënimit të përcaktuara në dispozitat relevante të KPP-së dhe të KPRK-së të qartësuar në pjesët e tjera të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e sipërcekura, e në bazë të nenit 401 të KPP-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

DEPARTAMENTI SPECIAL

APS.nr.15/2023

Datë: 13.04.2023

Bashkëpunëtorja Profesionale,

Anëtarët e kolegjit,

Kryetar i kolegjit,

Syzana Goxhuli

Bashkim Hyseni

Burim Ademi

Vaton Durguti